

VENDIM
Nr. 168, datë 15.5.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË 25.11.2019, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘MP-HEC’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘NIÇË’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2270 kw”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1361/1 prot., datë 12.5.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, mbi licencimin e shoqërisë ‘MP-HEC’ në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 2270 kw, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 25.11.2019, të ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 74, datë 22.4.2020, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 2270 kw për një afat 24 vjet e 2 muaj, me kusht që:

a) Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE pas nënshkrimit, kontratën shtesë të koncesionit, në vijim të miratimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC “Niçë”.

b) Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE “Lejen e shfrytëzimit të ujit” të rinovuar, në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, para fillimit të operimit të veprës.

2. Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE informacion mbi statusin e çdo dokumenti/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto dokumente/leje.

3. Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar para fillimit të operimit të veprës.

4. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1361 prot., datë 3.5.2023, shoqëria ka depozituar kontratën shtesë të koncesionit nr. 1780 rep., dhe nr. 556 kol., datë 20.6.2022, për miratimin e kapacitetit instaluar 2270 kw dhe vendimin e Këshillit të Basenit Ujor Seman, me nr. 5, datë 6.3.2023, për miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhimin hidroenergjetik për shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., me fuqi të instaluar 2270 kwh dhe lejen për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor me nr. 239 prot, datë 10.3.2023.

- Sa më sipër, me plotësimin e kushteve të vendosura në pikën 1, germat “a” dhe “b”, si dhe pikën 3 të këtij vendimi, vlerësohet të shfuqizohen.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2 të këtij vendimi, rezulton se i vetmi dokumentacion që mbetet për t’iu nënshtruar procedurës së rinovimit janë kontratat e qirasë për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor kombëtar. Në këto rrethana vlerësohet që ky kusht të ndryshohet duke i lënë detyrë shoqërisë të depozitojë në ERE kontratat e qirasë të rinovuara,

përkatësisht brenda datës 12.12.2025 kontratën e rinovuar me Bashkinë Maliq dhe brenda datës 29.9.2027, kontratën e rinovuar me Bashkinë Pogradec, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Germat “a” dhe “b” të pikës 1, si dhe pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187/2019, të ndryshuar, shfuqizohen.

2. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratat e qirasë të rinovuara, përkatësisht brenda datës 12.12.2025, kontratën e rinovuar me Bashkinë Maliq, dhe brenda datës 29.9.2027, kontratën e rinovuar me Bashkinë Pogradec, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti